



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:206163
Datë: 12.08.2024
Numri i dokumentit: 06040963

CAP.nr.1506/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike – përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, ndaj Sh. Z, Komuna e Malishevës, me objekt të përmbarimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.20/2020 i datës 11.09.2023, me datë 12.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.20/2020 i datës 11.09.2023, në pikën I dhe II të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Pika III e dispozitivit të aktvendimit PPP.nr.20/2020 të datës 11.09.2023, mbetet e pashqyrtuar

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.20/2020 i datës 11.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht të bazuar prapësimi e debitorit Sh. Z, me numër personal (numri personal), Komuna e Malishevës, i paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat “Ymer Kastrati” në Malishevë, me të cilin është lejuar propozimi për përmbarimi P.nr. 18/2020, i datës 24.02.2020. Në pikën II të dispozitivit ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr. 18/2020, i datës 24.02.2020, për periudhën kohore nga data 26.02.2015 e gjerë më datën 11.12.2018, në shumën prej 1,905.21 euro, për shkak të arritjes së parashkrimit. Në pikën III ka obliguar debitorin Sh.Z, nga fshati Mleqan, Komuna e Malishevës, që kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., (KESco), me adresë Bulv. “Bill Clinton”, nr. 3, Prishtinë, sa i përket pjesës tjetër të kërkesës ku në emër të borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike për periudhën 11.01.2019 e gjerë më datën 10.01.2020, t’ia paguaj borxhin në shumën prej 384,09 euro, me kamatë ligjore në larësin prej 8 %, ashtu që ka lënë në fuqi urdhri mbi lejimin e përmbarimit

P.nr.18/2020, të datës 24.02.2020, për këtë periudhë, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga nxjerrja e këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën IV ka vendosur se detyrohet debitori për shpenzimet e procedurës përmbarimore, në lartësinë e arritur deri më tani shumë prej 55,46 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat ose të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, Ymer Kastrati, në Malishevë, me urdhrin P.nr. 18/2020, datë 24.02.2020, ka lejuar propozimin për përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit me DGJ – 9029842, nga 26.02.2015 deri në vitin 10.01.2020, kundër debitorit Sh. Z, Komuna e Malishevës, në shumë prej 2,289,30 euro, me kamatëvonesë prej 8%, duke filluar nga dita e kalimit të afatit për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, ku mes tjerash ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin për shkak se borxhi është i parashkruar, dhe duke kërkuar nga kreditori precizimin e propozimit duke e llogaritur edhe parashkrimin sepse sipas dispozitave ligjore në fuqi borxhi vjetërsohet me kalimin e afatit prej 1 viti, duke pretenduar për shkelje të nenit 71 pika 1.4 dhe 1.6 të LPP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovon prapësimin.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar se pretendimet rreth parashkrimit nuk qëndrojnë sepse kreditori propozimin për përmbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm konform nenit 29 par.1.2 dhe 40 par.1 dhe 341 te LPP-së, propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 26.02.2015 e deri me 10.01.2020, dhe debitori ka bërë pagesa të kohëpaskohshme në vlera të ndryshme dhe konform nenit 368 par. 1 dhe 2 kemi ndërprerje të parashkrimit. Me tutje kreditori ka theksuar se kërkesa për prapësim nuk është në harmoni me nenin 69 par.4 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.20/2020 i datës 11.09.2023 ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pretendimet e debitorit, se ka arritur parashkrimi i borxhit, gjykata i mori pjesërisht si të bazuar, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me borxhin prej vitit 26.02.2015 e gjerë më datën 10.01.2020, lidhur me të cilin është paraqitur propozimi për përmbarim më datë 24.02.2020, me çka kuptojmë se

procedura përmbarimore është iniciuar pas 5 viteve nga koha kur është krijuar borxhi, ashtu që sa i përket borxhit për periudhën prej datës 26.02.2015 e gjerë më datën 11.12.2018, që kap shumën prej 1.905,21 euro, gjykata ka konstatuar se ka arritur parashkrimi në kuptim të nenit 360 par.1 nënpar. 1.1 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili parasheh se kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: janë “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, prandaj, për gjykatën kjo dispozitë ligjore është bazë e mjaftueshme e cila rregullon si dhe konstaton për kërkesat të cilat parashkruhen pas 1 viti, për këtë arsye ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktvendimit. Tutje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se borxhi për periudhën prej datës 11.01.2019 e gjerë më datën 10.01.2020, në shumën prej 384,09 euro, nuk kemi parashkrim të kërkesës përkatësisht borxhit të kërkuar nga kreditori për arsye se në këtë rast gjen zbatim neni 369 i LMD-së, i cili përcakton se: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”, gjë që në këtë rast kreditori ka filluar procedurën përmbarimore përmes propozimit për përmbarim si dhe urdhrët për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat, është përmbarimor qëllimi i kësaj norme për të ndërprerë parashkrimin për shkak të fillimit të kësaj procedure, gjë që rrjedhimisht gjykata ex-officio ka llogaritur afatin një (1) vjeçar të ndalimit të parashkrimit në përputhje të plotë me neni 360 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 29, 69, 71, 73 dhe 77 të LPP-së dhe dispozitat e nenit 8, 245, 360 dhe 369 të LMD-së, ndërsa sa i përket kamatës ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin pjesërisht të prapësimit të debitorit dhe shfuqizimit pjesërisht të urdhrët përmbarimor P.nr.18/2020, të datës 24.02.2020, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbarimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale. Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i ankimuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar duke e shfuqizuar urdhrin përmbarimor për periudhën kohore nga data 31.02.2015 e gjerë më datën 11.12.2018, për shumën prej 1.905,21 euro, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka

bërë aplikimin e të drejtës materiale, për arsye se në bazë të nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së parashihet: “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake...” ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet: “Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se debitori e ka pranuar borxhin duke bërë pagesa të kohëpaskohshme dhe rrjedhimisht është ndërprerë afati i parashkrimit, ngase sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.148/2012 i datës 09.09.2013 parashihet se pagesat eventuale që janë bërë për një periudhë nga debitori në formë të ndonjë pagese nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, përveç nëse mes palëve ka marrëveshje për riprogramim të borxhit apo ka specifikime të kërkesës për të cilën behet pagesa që në rastin konkret nuk ekzistojnë.

Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se pagesat e kohëpaskohshme debitori assesi nuk e ka pohuar detyrimin ndaj kreditorit, detyrimi në fjalë quhet i pohuar, kur palët dakordohen për riprogramim të borxhit duke përcaktuar afatet brenda të cilave debitori do detyrohej ta përmbushte detyrimin e tij ndaj kreditorit në këste të arritura sipas marrëveshjes. Faturat mujore të pranuar nga debitori nuk e kanë karakterin e kështit mujor, pasi termi kësht apo shumë periodike (zakonisht mujore), iu referohet kontratave kur ndërgjyqësit janë pajtuar paraprakisht për shumat fikse të përmbushjes së detyrimit, mos përmbushja e të cilave apo përmbushja eventuale do të pas sjellte ndërprerjen e rrjedhjes së parashkrimit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pika III e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar mbetet e pashqyrtuar në mungesë të pretendimeve ankimore në këtë pjesë të aktvendimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1506/2023 me datë 12.08.2024

Gjyqtarja
Frosina Sylejmani